

## A. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative

Departamenti i Shkencave Politiko Administrative, pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Albanian University ndjek dhe mbështet të njëjtën strategji të institucionit përse i përket zhvillimit institucional dhe politikave të kërkimit shkencor. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative si një organizëm me eksperiencë disa vjeçare, ka pasur një aktivitet kërkimor shkencor në proces formësimi. Pjesa më e madhe e pedagogëve të DSHPA kanë kryer studimet e tyre universitare, pasuniversitare, masterat dhe studimet doktorale në vendin tonë apo në vendet e Bashkimit Europian. Lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor në departamentin e shkencave politiko-administrative ka stimuluar kërkimin shkencor të pedagogëve të tij.

Krahas këtij aspekti, një rëndësi e veçantë i është dhënë transmetimit të teorive të përgjithshme, metodave të kërkimit dhe konkluzioneve të atyre punimeve shkencore të pedagogëve që kanë kaluar testin e pranimit nga katedrat ku këto studime janë mbrojtur.

Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative sipas planit të punës të hartuar në kuadër të Kërkimit Shkencor për Vitin Akademik 2018 - 2019 ka caktuar qëllimet e kërkimit shkencor, llojet e aktiviteteve si dhe një mundësi përfshirjeje në aktivitete ndërkombëtare të kërkimit shkencor duke zhvilluar edhe disa aktivitete dhe veprimtari shkencore. Cilësia në mësimdhënie dhe standardet në realizimin e saj janë kritere mbi të cilët ka bazuar punën e tij Departamenti i Shkencave Politiko Administrative.

Në realizimin dhe plotësimin e kurrikulave janë veprimtaritë kërkimore-shkencore të cilat kanë si qëllim të krijojnë hapësirat që programi i kualifikimit të stafit akademik të mund të kontribuojë në drejtim të rritjes së shprehive dhe aftësive të studentëve, që njohuritë profesionale të punës së një politologu të realizohen të plota duke e orientuar veprimtarinë e departamentit në këto drejtime:

- a) Aktivitete Shkencore në formën e Konferencave Shkencore, Simpoziumeve, tavolinave të Punës etj;
- b) Punime shkencore individuale të stafit pedagogjik dhe botimet e realizuara nga ata në nivel individual në revista shkencore shqiptare dhe të huaja;
- c) Pjesëmarrje në mënyrë të rregullt me artikuj në botimet e revistës "Optime", reviste shkencore e Universitetit tonë, të paktën dy artikuj në vit nga pedagogët e këtij departamenti;
- d) Angazhim në projekte të organizuar nga departamenti të stafit pedagogjik, të brendshëm apo të jashtëm.
- e) Kualifikim i vazhdueshëm i stafit akademik.

### Aktiviteti i punës kërkimore dhe shkencore për vitin akademik 2018-2019

1. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative organizon leksionin e hapur me temë: "Shekullarizimi përmes mediave on-line në Shqipëri dhe Kosovë" nën udhëheqjen e Phd. Candidate Jeta Abazi Gashi. Aktiviteti , i cili u realizua me dt. 31 tetor 2018, salla 24.

2. Zhvillimin e Konferencës së 5-të Ndërkombëtare, *"Problemet dhe Sfidat E Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standardeve të Bashkimit Europian"* në rang Fakulteti, e cila do të mbahet më 14 dhjetor 2018. Stafi i Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative është angazhuar për tu paraqitur me kumtesa të cilat do i dorëzohen brenda afateve të përcaktuara, organizatorëve të kësaj konference.
3. Në fokus të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative është gjithashtu nxitja e stafit akademik efektiv dhe stafit akademik me kontratë, për të botuar në revista të ndryshme shkencore ndërkombëtare ashtu edhe në revista kombëtare e më konkretisht në revistën e Albanian University "Optime". Gjithashtu pjesëmarrja e stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare do të jetë në fokus të kërkesave të Departamentit.
4. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është dhe konferenca studentore e cila mbahet çdo vit nga studentët e Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative dhe studentët e Departamentit të Shkencave Juridike me temë: *"Sistemi i drejtësisë në Shqipëri, ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve dhe Integrimin në BE"*. Nisur nga impakti që kjo temë sjell për studentët e të dy departamenteve, që në momenti që ju është prezantuar, ata kanë shfaqur interes dhe anagazhim për të marrë pjesë me kumtesat e tyre.
5. Dhjetor 2018, organizohet konferenca I-rë Ndërkombëtare studentore. Tematika e Konferencës parashikon të evidentojë problematika dhe sfida që po kalon vendi ynë dhe Maqedonia, të jepen zgjidhjet dhe risitë nga këndvështrimi i studentëve. Kjo konferencë studentore do të shoqërohet dhe me nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, Maqedoni dhe Albanian University- Tiranë, Shqipëri.

Tema e konferencës: *"Konsolidimi i Shtetit të së Drejtës në Shqipëri dhe Maqedoni në kuadër të integrimit të këtyre vendeve në BE"*.

6. Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative ka planifikuar realizimin, me studentet e Ciklit të parë të studimit Bachelor dhe studenteve të nivelit Master, në bashkëpunim me Qendrën e Studimit të Politikave Europiane për Zhvillimin Rajonal dhe Lokal (cdrls), një leksion të hapur në periudhën maj 2019, për të cilin jemi ende duke punuar për axhendën.
7. Aktivitet i përbashkët i Bibliotekës Kombëtare me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanian University. Leksion i hapur mbi mënyrat e kërkimit shkencor në Bibliotekën Kombëtare, në kuadër të përgatitjes të temave të kursit në lëndën Politikën në Ballkan (6 nëntor 2019).
8. Në kuadër të njohjes së politikave të ndjekura dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative mendon të organizojë në bashkëpunim me Drejtorinë e Vendeve të Rajonit dhe të Vendeve fqinje në Ministrinë e Jashtme në Tiranë, veprimtari informuese me studentët e të dy cikleve të studimit në periudhën (Janar - prill 2019).
9. Organizimi i takimeve/leksioneve të hapura është kthyer në një traditë të për departamentin tonë. Edhe këtë vit akademik ashtu si çdo vit tjetër departamenti do të organizohen leksione të hapura duke ftuar në auditoret tona studiues së politikave kombëtare dhe ndërkombëtare, diplomatë në karrierë ku gjatë këtyre takime do të

trajtohen problematikat në lidhje me çështjet më delikate të vendit, pikëpamjet e tyre, etj.

Emrat që parashikohen të jenë pjesëmarrës në orët e hapura, si dhe koha e realizimit do të ju bëhen me dije brenda muajit nëntor 2018, sipas një agjende të miratuar.

9. Janar 2019 në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike, do organizohet një leksion i hapur me studentët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ku si temë do trajtohet: "Përfaqësimi politik, transparencë dhe sfidat". Kjo është një nga çështjet që diskutohet më së shumti, ndaj dhe zgjedhëm ta trajtojmë edhe në aulat e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

Gjithashtu nuk duhet lënë pa përmendur dhe një angazhim i mundshëm në projektin Erasmus plus, projekt ky që do të mundësojë shkëmbimin e studentëve tanë me studentë të Universiteteve prestigjioze evropiane. Ajo do të përmirësojë performancën e studentëve, por njëkohësisht do të shërbejë dhe si eksperiencë për universitetin tonë në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe niveli i mësimdhënies.